

Ditët e Naimit në Tetovë: Konstandini i niset rrugës; Lisa midis Vermontit dhe Linit; Tualaleta në shkretëtirë (2008)



Rami Saari u lind më 17 shtator 1963 në Petah Tikva, Izrael. Është poet, përkthyes, gjuhëtar dhe kritik letrar. Ka studiuar dhe dhënë mësimë për gjuhësi semitike dhe uralike në universitetet e Helsinkit, Budapestit dhe Jerusalemit dhe ka mbrojtur doktoraturën e vet në Universitetin Hebraik të Jerusalemit (2003). Prej vitit 2003, Saari ndan kohën e vet mes Jerusalemit dhe Athinës. Deri në shkurt 2006, Saari ka botuar gjashtë libra me poezi dhe ka përkthyer më shumë se tridhjetepesë libra, prozë si dhe në poezi, nga shqipja, estonishtja, finlandishtja, greqishtja, hungarishtja, portugalishtja dhe spanjishtja. Nga shqipja ka përkthyer poetet dhe shkrimtarët shqiptarë Ismail Kadare, Dritëro Agolli, Xhevahir Spahiu, Ali Podrimja, Nasi Lera, Visar Zhiti, Lindita Arapi, Shaip Emërllahu, Blendi Fevziu, Lindita Karadaku, Mira Meksi, Betim Muço dhe Dhimitër Pojanaku. Poezinë e Saarit e kanë përkthyer në shqip Natasha Lushaj, Silke Liria Blumbach dhe Andi Kosta. Poezi të veçantë e Saarit janë botuar në shqip, katalanisht, anglisht, estonisht, finlandisht, frëngjisht, gjermanisht, greqisht, japonisht, maqedonisht, rusisht dhe spanjisht. Prej vitit 2002, Saari ka qenë redaktori kombëtar i faqeve të Izraelit në web-faqen e poezisë. Në vitet 1996 dhe 2003 u shpërblye me Cmimin e Kryeministrit për Letërsi dhe në vitin 2006 u shpërblye me Cmimin Cernikhovsky për përkthimet e tij.

KOSTANDINI I NISËT RRUGËS

Para se të ikësh,
as bir, as vëlla,
as shok, as dashnor, por
më shumë se një prekje prej tyre -
mbaje dorën time të fortë
në dorën tënde të hollë, që njohu kënaqësi
dhe hidhërim dhe netë të stuhishme.
E tëra ime, më shumë se çdo gjë tjetër, do
(e tëra ime, jo përsëri) të të mbajë ngushtë,
për një çast çast
të jemi një mish e gjak
dhe një farë dhe të gjitha gjërat që janë një,
Megjithatë, po, megjithatë
i marr duart e tua të mira në të miat
dhe të çoj te dera,
të dërgoj si një pëllumb, Kostandin,
në botën e gjerë.
Në stuhitë që do të takosh,
në hidhërimin dhe gëzimin që do të mbash,
vëllai dhe i biri im, miku dhe dashnori im,
dhembshuria ime do të të përcjellë përherë,
e papastër ndoshta nganjëherë,
por e lumtur për gëzimin që do të gjesh.
Të ndihmofshin qiejt, të mbrofshin,
burrë, deri në fund të rrugës.

LISA MIDIS VERMONTIT DHE LINIT

Jeta është larg vendit
që zgjedh për pushimet,
ndonëse je në të vërtetë

një person praktik. Në fakt,
me gjithë interesin tënd në poezi,
ke arritur moshën e mesme pa
një librin tënd në çantën tënde,
me integritetin aq të ulur sa Deti i Vdekur.

Prandaj nuk mund të pretendoj
që e ke kokën në retë,
ndonëse shumë fluturuake
kur nuk lidhesh me zinxhirin e semestrave
në kalanë e studiuesve
në majë të Malit Skopus.
Unë jam i lirë nga këto detyra -
s'kam nevojë t'u privohem festivaleve poezie
gjatë vitit shkollor -
por gjithsesi nuk ka fluturime
për vendet që më tërheqin.
Arrin atje, po qe se arrin,
me autobus, me kalë,
me tren ose më këmbë.

Tani je e ulur me mua
në këtë restaurant shqiptar,
me mjaft para në xhepin tim
për të të blerë 200 filxhanë kafe.
A është varfëria më tërheq këtu
apo dëshira për të kaluar netët e mia
në mes të mjeshtrave të pashëm të zanateve
që prej kohësh janë zhdukur nga bota -
policë që ecin me ritëm,
regjës gëzofesh,
bujq pronarë toke
dhe shërues me shushunja?

Nuk e di as nuk di ti.

Ne të dy në mes të jetës,
të ngecur dhe tani të lirë
për t'u ulur në skaj të liqenit
në zemër të asnjë vendi,
të zhytur në soditje të thellë
në rrugën e asgjëkundit.

Pogradec, tetor 2005

TUALETA NË SHKRETËTIRË

Këto nuk janë veç guaska në plazh,
Këmbalka në këmbët e tua,
Eshtra të thyer fosilesh
Dhe tualeta në shkretëtirë.

Nuk u mbet pothuajse asgjë
Nga ajo që ishte madhështore dhe që iku,
Nuk ka asgjë përveç shiut
Në zemrën e thatë dhe të mërzitshme,
Aq të qetë dhe të lodhur sa një kufomë që nuk sheh.

Dhe dashuria
Jeton tutje
Në këtë vend të largët:
Hapësira e vulosur
Ku lindin fjalët.

Source:

<https://www.ditetenaimit.org/wp-content/uploads/2018/10/ANTOLOGJI-ditet-e-naimit-2008.pdf>